

URDHËR
Nr. 308, datë 28.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE,
TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
 - a) të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra;
 - b) materialit biologjik dhe të pashoqëruara me test diagnostik PCR-je të rezultuar negativ i bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;
 - c) mishit të freskët;
 - ç) produkteve të mishit të patrajuara me të paktën me një temperaturë prej 70°C për 30 minuta;
 - d) qumështit dhe produkteve të qumështit të patrajuara termikisht me një temperaturë minimale prej 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë – kohë e shkurtër pasterizimi (HTST) e aplikuar 2 herë) ose çdo trajtim tjetër ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;
 - dh) leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të papërpunuara të patrajuara ose papërpunuara ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;
 - e) ushqimit me përmbajtje proteinike dhe ushqimit të kafshëve ruminantë dhe derra të patrajuara termikisht ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike.

Sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e ADIS-it dhe WAHIS, përkatësisht nga ndarjet administrative të tabelës së mëposhtme, të shtetit të Hungarisë:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Győr-Moson-Sopron*	Győr*	
Győr-Moson-Sopron*	Mosonmagyaróvár*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra, materialit biologjik, embrioneve, mishit të freskët, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, qumështit, produkteve të qumështit, miellit të mishit, miellit të gjakut, leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të trajtuara dhe të papërpunuara, dhe ushqimit të kafshëve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra.

3. Urdhri nr. 238, datë 7.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj